

PROJEKTLIGJ

Nr. / 2020

“PËR REFERENDUMET”

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, pika 2, shkronja “ç”, dhe neni 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e sektorit të shoqërisë civile, të përfaqësuar në këtë iniciative nga Qendra për Çështje të Informimit Publik dhe të deputetëve.....

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

1. Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e rregullave për për thirrjen e referendumit, formulimin e pyetjes/çështjes, përgatitjen, zhvillimin, administrimin dhe shpalljen e rezultatit të referendumeve në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Referendum”**- është formë e ushtrimit të drejtpërdrejtë të sovranitetit të popullit përmes demokracisë direkte që i lejon shtetasit të shprehin vullnetin e tyre përmes votës, për të pranuar ose refuzuar një çështje me rëndësi publike ose politike, në nivel qendror apo vendor.
2. **“Referendum i përgjithshëm”**- është referendumi që zhvillohet në një ditë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe rezultati i tij ka fuqi detyruese të përgjithshme.
3. **“Referendum kushtetues”** është shprehje e drejtpërdrejtë e vullnetit popullor për pranimin ose refuzimin e draftit për një Kushtetutë të re, apo ndryshimeve të Kushtetutës aktuale.
4. **“Referendum kushtetues i drejtpërdrejtë”** është referendumi i përgjithshëm i cili thirret nga Kuvendi për çështje që lidhen me ndryshimin e Kushtetutës, kur vetë Kuvendi

nuk shprehet paraprakisht me votë apo nuk ka dakordësi politike për projekt-amendamentet kushtetuese të paraqitura.

5. **“Referendum kushtetues ratifikues”** është referendum i përgjithshëm i cili thirret nga Kuvendi për çështje që lidhen me amendimin e Kushtetutës, kur vetë Kuvendi ka votuar më parë dhe ka miratuar ligjin për amendimin kushtetues, por të cilin kërkon ta ratifikojë më votë popullore direkte, për të siguruar një konsensus sa më të gjerë.
6. **“Referendumi legjislativ”** është referendumi i përgjithshëm i thirrur për një çështje legjislative të rëndësisë së veçantë, për të cilën Kuvendi ose Këshilli i Ministrave, në tagrin e institucionit që ka nismën ligjvënëse, gjykon se vullneti vendimmarrës është i pamjaftueshëm për t’i dhënë legjitimitetin e synuar një projekligji të caktuar apo kur vetë Kuvendi nuk arrin dot në vendimmarrje për këtë çështje me mekanizmat që disponon për shkak të qëndrimeve të papajtueshme të grupeve vendimmarrëse.
7. **“Referendum shfuqizues”** është procesi që mundëson zbatimin e të drejtës kushtetuese që gëzojnë 50 mijë shtetas me të drejtë vote për shfuqizimin e një ligji përmes votës së drejtpërdrejtë në referendum.
8. **“Referendumi i thjeshtë”** është referendumi i thirrur nga 50 mijë shtetas me të drejtë vote për një çështje të rëndësisë së veçantë, për çështje të të drejtave të njeriut, të drejtave civile dhe politike, ose çështje të tjera si mirë-përdorimi/administrimi i pasurisë publike, burimeve ujore dhe/ose pasurive natyrore, çështje mjedisore, të shëndetit publik, etj.
9. **“Referendum vendor”** është një nga mekanizmat/format e vetëqeverisjes vendore, ku banorët e një njësie të qeverisjes vendore shprehen me votim të drejtpërdrejtë për çështje që konsiderohen me rëndësi për komunitetin dhe që janë nën juridiksionin dhe autoritetin vendimmarrës të njërive të qeverisjes vendore ku ata banojnë.
10. **“Nisma referendare”** është procesi në të cilin organi vendimmarrës i legjitimuar ose një numër i përcaktuar shtetasish shqiptarë me të drejtë vote marrin nismën për të siguruar sipas rastit, vendimmarrjen ose votat e nevojshme për thirrjen e një referendumi.
11. **“Grupi Nismëtar”** - janë një grup jo më i vogël se 15 shtetas me shtetësisshqiptare me të drejtë vote të cilët marrin nismën për zhvillimin e një referendumi.
12. **“Njësitë e vetëqeverisjes vendore”** - janë bashkitë ose qarqet, të cilat realizojnë vetëqeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë.
13. **“Organi përfaqësues”** - është këshilli bashkiak në rang bashkie dhe këshilli i qarkut në rang qarku.
14. **“Fushatë për referendumin”** - është procesi i cili përfshin çdo deklaratë e vullnetshme publike, ngjarje ose aktivitet të çdo forme apo lloji që përmban ftesën e drejtpërdrejtë apo të tërthortë për të thirrur një referendum, për të votuar pro ose kundër çështjes që shtrohet për/në referendum dhe çdo ftesë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë për të marrë ose jo pjesë në një referendum deri 24 orë para zhvillimit të votimit.
15. **“Nënshkrimi elektronik”** – është procesi i dhënies së pëlqimit për mbajtjen e një referendumi nga shtetasi shqiptar me të drejtë vote, përmes nënshkrimit elektronik, sipas parashikimeve që përmban Ligji Nr.9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, *i ndryshuar*

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti. Referendumi është një nga format e ushtrimit të drejtpërdrejtë të sovranitetit të popullit.
2. Referendumet mund të jenë të përgjithshme ose vendore. Vendimet e marra në referendum të përgjithshëm kanë fuqi juridike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Vendimet e marra me referendum vendor kanë fuqi juridike vetëm në territorin e bashkisë apo qarkut ku mbahet referendumi, përveç rastit kur çështjet që shtrohen për votim brenda territorit të një bashkie lidhen me fushën e përgjegjësisë së institucioneve qendrore e që lidhen me trashëgiminë dhe identitetin kombëtar .
3. Parimet dhe rregullat për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm ose vendor, si dhe procedura dhe vlefshmëria e rezultateve të tij përcaktohen në këtë ligj.
4. Përsa nuk është parashikuar në këtë ligj zbatohen drejtpërdrejtë dispozitat e Kushtetutës dhe dispozitat e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

E drejta për referendum

1. E drejta për referendum garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si formë e ushtrimit të drejtpërdrejtë të sovranitetit të popullit.
2. Çdo shtetas shqiptar që plotëson kushtet për të qenë zgjedhës ka të drejtë të marrë pjesë në referendum.
3. Shteti garanton që shtetasit shqiptarë në referendum të shprehin vullnetin e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë, me votim të lirë, të fshehtë dhe të barabartë.
4. Shtetasit shqiptarë e ushtrojnë lirisht të drejtën për të ndërmarrë nismën për thirrjen e një referendumi të përgjithshëm dhe/ose vendor, si dhe të drejtën për të marrë pjesë aktive në organizimin e tij.
5. Çdo formë kontrolli apo influence e ushtruar ndaj vullnetit të lirë të shtetasve për të thirrur referendum apo për të shprehur vullnetin e tyre të lirë mbi çështjet e shtruar në referendum është e ndaluar dhe ndëshkohet sipas legjislacionit penal në fuqi, Kreu X, i Kodit Penal, “*Dispozitat që trajtojnë veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve*”.

Neni 5

Transparenca e procesit të referendumit

1. Procedura për mbajtjen e referendumit duhet të jetë transparente dhe publike. Ky ligj ngarkon KQZ-në dhe institucionet e tjera publike, që kanë një rol të përcaktuar në

zhvillimin dhe administrimin e procesit zgjedhor të referendumeve me detyrimin për të garantuar mbarëvajtjen e referendumit.

2. Çdo shtetasi me të drejtë vote në Republikën e Shqipërisë i garantohet e drejta për t'u njohur paraprakisht dhe efektivisht përmes mjeteve të komunikimit masiv për nismën e referendare, çështjet e shtruara për referendum, opsionet e votimit, qendrat e votimit, procedurën e votimit dhe rezultatin përfundimtar pas numërimit të votave për referendumin.
3. Thirrja e referendumit, kontrolli i vlefshmërisë së nismës, administrimi i procesit të votimit për referendumin dhe nxjerrja e rezultatit bëhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

Raporti i përgjegjesive dhe kostot financiare

1. Grupi Nismëtar për Referendum është përgjegjës vetëm për nisjen e procesit së referendumit sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe nuk mban përgjegjësi për zhvillimin, shpenzimet e administrimit zgjedhor dhe mbarëvajtjen e referendumit.
2. KQZ është organi përgjegjës për fushtën referendare, administrimin zgjedhor dhe mbarëvajtjen e referendumit deri në shpalljen e rezultatit të tij.
3. Sipas rastit, organet e përcaktuara në këtë ligj mund të bashkëpunojnë edhe me organe dhe institucione të tjera publike apo me organizata të shoqërisë civile dhe/ose parti politike për mbarëvajtjen e referendumit.
4. Shpenzimet për mbajtjen e referendumeve përballohen nga buxheti i shtetit.

Neni 7

Kufizimet e të drejtës për referendum

1. Çështjet që lidhen me tërësinë territoriale të Republikës së Shqipërisë, me kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, me buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit, me vendosjen dhe heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme, me deklarimin e luftës dhe të paqes dhe me amnistinë nuk mund të shtrohen në referendum.
2. Referendumi për të njëjtën çështje nuk mund të përsëritet përpara se të kenë kaluar tre vjet nga zhvillimi i tij.
3. Asnjë referendum nuk mund të zhvillohet në datën e zgjedhjeve për Kuvend ose për organet e vetëqeverisjes vendore.
4. Nuk mund të zhvillohet referendum i përgjithshëm deri në 3 muaj pas mbledhjes së parë të Kuvendit të ri dhe 3 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit.
5. Kur shpallen zgjedhje të parakohshme për Kuvendin, procedura për zhvillimin e referendumit pezullohet deri pasi të kenë kaluar 3 muaj nga mbledhja e parë e Kuvendit të ri. Vendimi i pezullimit merret brenda 5-ditëve nga bërja publik i faktit të shpalljes së

zgjedhjeve të parakohshme. Vendimi merret nga KQZ kryesisht ose me kërkesë të grupit nismëtar/organizator. Pas marrjes së vendimit KQZ mënjuhërë informon publikun për vendimin e marrë duke e publikuar vendimin në faqen e saj të internetit, shtypin e shkruar dhe elektronik, median audiovizive dhe në Fletoren Zyrtare.

6. Nuk mund të zhvillohet referendum vendor deri 6 muaj nga fillimi i mandatit të organit të vetëqeverisjes vendore dhe 3 muaj para përfundimit të mandatit.
7. Kur në një njësi të vetëqeverisjes vendore shpallet mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme, procedura për zhvillimin e referendumit vendor në atë njësi pezullohet deri pasi të kenë kaluar 5 muaj nga fillimi i mandatit të organit të vetëqeverisjes vendore.
8. Gjatë periudhës së zbatimit të masave të jashtëzakonshme nuk mund të zhvillohet asnjë referendum.

KREU II

LLOJET E REFERENDUMEVE DHE NISMETARET

Neni 8

Llojet e referendumeve

1. Referendumet në Republikën e Shqipërisë mund të jenë të përgjithshme ose vendore.
2. Referendumet e përgjithshme kanë fuqi juridike në të gjithë territorin e vendit, kurse ato vendore kanë fuqi juridike vetëm në territorin juridiksional të njësisë së qeverisjes vendore, përveç rasteve të parashikuara në nenin 3, pika 2 paragrafi i dytë i këtij ligji.
3. Referendumet vendore mund të zhvillohen në Nivel Qarku ose në Nivel Bashkie. Në rast të ndryshimit me ligj të niveleve të qeverisjes vendore, referendumet vendore zhvillohen në ato nivele të organizimit territorial apo administrativ që caktohen me ligjin e ri për ndarjen administrative dhe territoriale.
4. Referendumet mund të organizohen me nismën e organit më të lartë përfaqësues në nivel qendror ose vendor. Në një rast të tillë ato klasifikohen si referendume me iniciativë nga Lart-Poshtë.
5. Referendumet, mund të organizohen me nismën e drejtpërdrejtë të shtetasve shqiptarë me të drejtë vote. Në këtë rast ato klasifikohen si referendume nga Poshtë –Lart.
6. Qytetarët kanë të drejtë të marrin nismën për të zhvilluar referendum të përgjithshëm ose vendor, konform parimeve dhe rregullave që përmban ky ligj.

Neni 9

Referendumi kushtetues

1. Referendumi kushtetues është shprehje e drejtpërdrejtë e vullnetit të popullit për pranimin ose refuzimin e ndryshimeve në tekstin aktual të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ose për pranimin ose refuzimin e një Kushtetute të re të hartuar nga Kuvendi.

2. Kuvendi mund të vendosë, me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij, që projekt-amendamentet kushtetuese të votohen drejtpërdrejt me referendum në popull pa u votuar paraprakisht në seancë plenare në Kuvend. Në kuptimin e këtij ligji, në këtë rast ai quhet Referendum Kushtetues i Drejtpërdrejtë.
3. Kuvendi mund të miratojë vetë më parë amendamentet kushtetuese dhe më pas të kërkojë ratifikimin e ligjit kushtetues të miratuar prej tij përmes referendumit të përgjithshëm kur këtë e kërkon një e pesta e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në kuptimin e këtij ligji, në këtë rast ai quhet Referendum Kushtetues Ratifikues.

Neni 10

Nisma për Referendumin Kushtetues

1. Nisma për referendumin kushtetues i përket Kuvendit, për sa kohë përcaktimi kushtetues mbi rezervën ekskluzive të tij mbetet i pandryshuar.
2. Kuvendi shprehet me ligj për mbajtjen e referendumit si në rastin kur ai është referendum kushtetues i drejtpërdrejtë ashtu edhe kur ai është referendum kushtetues ratifikues.
3. Nisma për rishikimin e Kushtetutës mund të ndërmerret nga jo më pak se një e pesta e anëtarëve të Kuvendit.
4. Asnjë rishikim i Kushtetutës nuk mund të ndërmerret gjatë kohës kur janë vendosur masat e jashtëzakonshme.
5. Projekti miratohet nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.
6. Kuvendi mund të vendosë, me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij, që projektamendamentet kushtetuese të votohen me referendum. Projektligji për rishikimin e Kushtetutës hyn në fuqi pas ratifikimit me referendum, i cili bëhet jo më vonë se 60 ditë nga miratimi i tij në Kuvend.
7. Amendamenti kushtetues i miratuar i nënshtrohet referendumit, kur këtë e kërkon një e pesta e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.
8. Presidenti i Republikës nuk ka të drejtë ta kthejë për rishqyrtim ligjin e miratuar nga Kuvendi për rishikimin e Kushtetutës.
9. Ligji i miratuar në referendum shpallet nga Presidenti i Republikës dhe hyn në fuqi në datën e parashikuar në këtë ligj.
10. Rishikimi i Kushtetutës për të njëjtën çështje nuk mund të bëhet përpara se të ketë kaluar një vit nga dita e rrëzimit të projektligjit në Kuvend dhe jo më përpara se të kenë kaluar 3 vjet nga dita e rrëzimit të tij në referendum.

Neni 11

Referendumi i përgjithshëm legjislativ

1. Referendum i përgjithshëm legjislativ mbahet për një çështje legjislative të rëndësisë së veçantë, për të cilën Kuvendi, me vendimmarrjen e vet ose me propozimin e Këshillit të

Ministrave, vlerëson se vullneti vendimmarrës brenda tij është i pamjaftueshëm për t'i dhënë legjitimitetin e synuar një projektligji të caktuar.

2. Referendumi i përgjithshëm legjislativ mund të thirret për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, për një projektligj të rëndësishëm, apo për rastet kur vetë Kuvendi nuk arrin dot një vendimmarrje për një çështje të rëndësisë së veçantë.
3. Kuvendi shprehet me ligj për thirrjen dhe zhvillimin e referendumit të përgjithshëm legjislativ.
4. Data për thirrjen e referendumit duhet të jetë jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit për këtë qëllim.
5. Presidenti i Republikës nuk ka të drejtë ta kthejë për rishqyrtim ligjin e miratuar nga Kuvendi për thirrjen dhe zhvillimin e referendumit të përgjithshëm legjislativ.
6. Ligji i miratuar me referendum shpallet nga Presidenti i Republikës solemnisht, jo më vonë se 24 orë pasi KQZ bën publik rezultatin e votimit dhe hyn në fuqi ditën e përcaktuar nga vetë ligji i miratuar, pasi botohet më parë në Fletore Zyrtare.

Neni 12

Nisma për referendumin e përgjithshëm legjislativ

7. Kuvendi, me propozimin e jo më pak se një të pestës së të gjithë anëtarëve të tij, mund të vendosë që ratifikimi i një apo disa marrëveshjeve ndërkombëtare të bëhet me referendum të përgjithshëm legjislativ.
8. Kuvendi shprehet me ligj për ratifikimin me referendum të marrëveshjeve ndërkombëtare. Ky ligj miratohet me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.
9. Kuvendi, me propozimin e jo më pak se një të pestës së anëtarëve të tij, mund të vendosë që një projektligji i rëndësisë së veçantë të shtrohet për vendimmarrje në popull me referendum të përgjithshëm. Në këtë rast, Kuvendi konsiderohet nismëtar i referendumit.
10. Kuvendi, me propozimin e arsyetuar të Këshillit të Ministrave, mund të vendosë që një projektligj i rëndësisë së veçantë, nismën ligjore për të cilin e ka marrë Këshilli i Ministrave, të shtrohet për vendimmarrje direkte me referendum të përgjithshëm.

Neni 13

Referendumi shfuqizues

1. Populli, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, ka të drejtën të thirrjes së referendumit për shfuqizimin e një ligji të Kuvendit.
2. Një ligj i Kuvendit quhet i shfuqizuar kur në referendumin e organizuar për këtë qëllim kanë votuar "PRO" shfuqizimit më shumë se gjysma e shtetasve me të drejtë vote që kanë marrë pjesë në referendum.
3. Ligji i shfuqizuar me referendum humbet fuqinë e tij juridike jo më parë se 3 muaj nga data e shpalljes së rezultatit të referendumit dhe jo më vonë se 6 muaj nga shpallja e këtij rezultati.

4. Kostot financiare të shkaktuara apo të rikuperuara nga shfuqizimi me referendum i një ligji, riallokohen në ligjin pasardhës të buxhetit të shtetit, nëse kjo konsiderohet e mundur ose e nevojshme. Ministrinë e linjës bëjnë vlerësimin e kostove dhe hartojnë relacionin i cili i bashkalidhet projektligjit të ardhshëm për buxhetin e shtetit ose në ligjin më të parë për ndryshimet e tij.
5. Në rast nevoje dhe urgjence, Këshilli i Ministrave mund të nxjerrë akte normative me fuqinë e ligjit konform parashikimeve të nenit 101 të Kushtetutës për ndryshime apo shtesa në ligjin për Buxhetin e Shtetit.

Neni 14

Nisma për referendum shfuqizues

1. Nisma për mbajtjen e një referendumi shfuqizues mund të merret nga të paktën 15 shtetas shqiptar me të drejtë vote, ose nga organizatat e shoqërisë civile dhe/ose partitë politike të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi.
2. Nisma për referendum shfuqizues duhet të hartohet në formën e një propozimi të shkruar, i cili duhet të përmbajë ligjin që kërkohet të shfuqizohet si dhe një apo disa argumenta kryesorë PRO shfuqizimit të tij.
3. Nisma për referendumin shfuqizues, pasi merr pëlqimin e 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, i paraqitet nga përfaqësuesit e autorizuar Presidentit të Republikës dhe KQZ-së së bashku me kërkesën zyrtare për mbajtjen e referendumit.
4. Me marrjen e kërkesës për mbajtjen e referendumit, KQZ-ja njofton zyrtarisht brenda 5 ditëve Kuvendin mbi propozimin e ardhur për referendum.
5. Grupi nismëtar i referendumit, por edhe subjektet që legjitimohen sipas nenit 134 të Kushtetutës kanë të drejtë t'i kërkojë Gjykatës Kushtetuese verifikimin paraprak të kushtetushmërisë së çështjes së shtruar për referendum shfuqizues.

Neni 15

Referendumi i thjeshtë

1. Populli, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, ka të drejtën t'i kërkojë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë.
2. Referendumi i thjeshtë mbahet për çështje të të drejtave të njeriut, të drejtave civile dhe politike, të mirëpërdorimit të pasurisë/pronës publike, burimeve ujore dhe pasurive natyrore, çështje mjedisore, çështje të shëndetit publik, të kujdesit riprodhues të njeriut dhe çështje të tjera që paraqesin në një moment të caktuar ndjeshmëri të lartë publike.
3. Referendumi i thjeshtë mund të mbahet edhe për ratifikimin ose jo të një marrëveshje ndërkombëtare në përputhje me nenin 123 paragrafin 3 të Kushtetutës si dhe për çështje që lidhen me vendimin për t'u bashkuar apo dalë nga një aleancë apo organizatë ndërshtetërore.
4. Referendumi i thjeshtë mund të thirret edhe për çështje të vetëtaksimit për një dobi të caktuar publike.

Neni 16

Nisma për referendum të thjeshtë

1. Nisma për mbajtjen e një referendumi të thjeshtë mund të merret nga të paktën 15 shtetas shqiptare me të drejtë vote, organizatat e shoqërisë civile dhe/ose partitë politike të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
2. Nisma për referendum duhet të përmbajë një propozim konkret, i cili hartohet me shkrim, nënshkruhet nga anëtarët e grupit nismëtar dhe depozitohet zyrtarisht në KQZ.
3. Me marrjen e kërkesës për mbajtjen e referendumit, KQZ-ja njofton brenda 5 ditëve në lidhje me propozimin e ardhur Kuvendin dhe Presidentin e Republikës.
4. Procedura për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për aktivizimin e nismës për referendum kryhet sipas mënyrës së përcaktuar në këtë ligj dhe në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 17

Referendumi vendor

1. Vetëqeverisja dhe vendimmarrja në njësitë e qeverisjes vendore ushtrohet edhe përmes referendumeve vendore, si formë e demokracisë së drejtpërdrejtë.
2. Referendumi vendor mund të zhvillohet në nivel bashkie ose në nivel qarku.
3. Referendumi vendor mund të zhvillohet për:
 - a) çështje që prekin bashkësinë dhe që përfshihen brenda kompetencave ligjore dhe territoriale të organeve të njësisë së vetqeverisjes vendore;
 - b) vetëtaksimimin e banorëve për qëllime publike, brenda kufijve të detyrave, funksioneve dhe kompetencave lëndore dhe territoriale të organeve të vetqeverisjes vendore;
 - c) shkarkimin e këshillit bashkiak, këshillit të qarkut.
 - d) çështje të tjera me natyrë mjedisore, shoqërore, ekonomike, kulturore apo normash etike për të cilat bashkësia/komuniteti shfaq interes të posaçëm.

Neni 18

Nisma për referendumin vendor

1. Nismën për zhvillimit e referendumit vendor e kanë të paktën 15 shtetas shqiptar me të drejtë vote që janë banorë të njësisë në të cilën thirret referendumi vendor, ose një organizatë e shoqërisë civile që ka personalitet juridik, veprimtaria aktive e të cilës, sipas statutit të saj, është e shtrirë të paktën në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ku thirret/mbahet referendum vendor.

2. Nismën për zhvillimit e referendumit vendor e kanë edhe një e treta e anëtarëve të këshillit të bashkisë ose të qarkut. Në këtë rast nisma për referendum duhet të miratohet me shumicën e të gjithë anëtarëve të këshillit të bashkisë ose të qarkut.
3. Kryetari i Bashkisë mund t'i propozojë këshillit bashkiak thirrjen e referendumit vendor. Këshilli Bashkiak miraton kërkesën e paraqitur nga kryetari i bashkisë me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij.

KREU III

PROCEDURA PËR THIRRJEN E REFERENDUMEVE

Neni 19

Projekti i propozuar për referendum

Projekti i propozuar për referendum duhet të përmbajë:

- a) llojin e referendumit dhe arsyen e zhvillimit të tij;
- b) subjektin(et) nismëtar;
- c) tekstin e propozuar për referendum, të hartuar sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- d) nënshkrimet e grupit nismëtar;
- e) personin që do të atashohet pranë KQZ për të koordinuar procesin referendar;
- f) nëse propozues janë organizatat e shoqërisë civile dhe/ose partitë politike, projekti i propozuar duhet të përmbajë përveç nënshkrimeve, edhe vulën e subjektit juridik.

Neni 20

Mbledhja e nënshkrimeve

1. Për referendumet nga Poshtë-Lart, grupi nismëtar për referendumin paraqet në KQZ kërkesën me shkrim për marrjen e miratimit për nismën për referendum. KQZ-ja shqyrton në një seancë publike kërkesën brenda 10 ditësh nga paraqitja e saj. KQZ siguron transmetimin live të kësaj seance deri në shqyrtimin përfundimtar të saj.
2. Brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit të KQZ për lejimin e nismës, Grupi Nismëtar bën publike me mjete të ndryshme mediatike qëllimin e nismës, mënyrën dhe mjetet e organizimit, kalenderin e aktiviteteve që do të kryhen për mbështetjen e nismës së referendumit si dhe vendet dhe oraret përkatëse.
3. KQZ akordon fond të posaçëm në dispozicion të fushatës për informim të publikut për nismën referendare jo më vonë se 20 ditë nga marrja e vendimit prej saj.
4. KQZ ka detyrimin për të garantuar përmes buxhetit të saj informim efektiv përmes medias audio-vizive me mbulim kombëtar lidhur me qëllimin e nismës referendare, afatet e grumbullimit të firmave dhe shpërndarjen e tyre gjeografike, si dhe të informojë zgjedhësit përmes medias mbi ecurinë e procesit të nënshkrimit të paktën 2 herë në javë.
5. Mbledhja e nënshkrimeve për referendum bëhet në vende publike, sipas përcaktimeve që bën Grupi Nismëtar në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore. Grupi Nismëtar mund të vendosë që të

aktivizojë vullnetarë për të mbledhur firma derë më derë, duke detajuar paraprakisht protokollin e komunikimit të vullnetarëve me nënshkruesit.

6. KQZ-ja vë në dispozicion të procesit të mbledhjes së firmave për referendum të gjithë bazën materiale të nevojshme, me fletë të sigluara prej saj, sipas specifikime teknike të përcaktuara.
7. Formatin që përdoret për mbledhjen e nënshkrimeve përcaktohet me vendim të KQZ-së dhe duhet të përmbajë:
 - a) çështjen që shtrohet për referendum;
 - b) numrin rendor,
 - c) emrin dhe mbiemrin e votuesit,
 - d) numrin e kartës së identitetit apo pasaportës,
 - e) datëlindjen,
 - f) vendlindjen dhe vendbanimin,
 - g) nënshkrimin dhe datën.

Neni 21

Nënshkrimi elektronik

1. Nënshkrimet për nismën referendare mund të mblidhen tërësisht ose pjesërisht edhe në rrugë elektronike, online përmes portalit që mundëson këtë shërbim, në përputhje me standartet e pranuar për nënshkrimin elektronik dhe ofruesit e këtij shërbimi në Republikën e Shqipërisë.
2. Mbledhja e nënshkrimeve online është pa pagesë. Ato i bashkalidhen nënshkrimeve që mund të mblidhen përmes metodës së firmosjes së fletëve të sigluara nga KQZ. Të dyja llojet e nënshkrimeve, si ai elektronik online ashtu dhe ai në letër kanë vlerë të njëjtë në procesin e numërimit dhe vlerësimit nga KQZ.
3. Grupi Nismëtar i referendumit cakton 3 përfaqësues me prokurë të posaçme që të ndërveprojnë me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe KQZ për efekt të përcaktimit të modaliteteve të mbledhjes së nënshkrimeve elektronike online, në përputhje me standartet ligjore në fuqi.
4. Në çdo rast, pas një nënshkrimi online në portalin përkatës, sistemi mundëson për përsoruesit e vet printimin në PDF ose në letër të një çertifikate që e provon këtë nënshkrim.
5. KQZ, me kërkesë të saj ose të Grupit Nismëtar/Komiteti Përfaqësues, vendos në dispozicion faqen e vet zyrtare për të mbledhur nënshkrime elektronike online mbi nismën e referendumit.
6. KQZ informon zgjedhësit përmes një tutoriali shpjegues në audio-video në faqen e vet zyrtare mbi mënyrën se si funksionon nënshkrimi elektronik, si dhe mbi mënyrën e depozitimit të firmave elektronike për nismën konkrete referendare të hapur për nënshkrim nga zgjedhësit.
7. Formatin që përdoret për mbledhjen e nënshkrimeve elektronike është i njëjtë në përmbajtje me atë që KQZ ka përcaktuar me vendim për nënshkrimet në letër.
8. Në përfundim të afatit siç përcaktohet me këtë ligj, Autoriteti ose administratori i portalit i dorëzon Grupit Nismëtar/Komitetit Përfaqësues certifikatat e printuara dhe/ose dokumentacionin që provon numrin e nënshkrimeve elektronike, të cilat bëhen pjesë e dokumentacionit që i dorëzohet KQZ-së.

Neni 22

Afati për mbledhjen e nënshkrimeve për referendumin

1. Periudha për mbledhjen e nënshkrimeve zgjat jo më shumë se 3 muaj nga shpallja/marrja e vendimit të KQZ-së për miratimin e iniciativës propozuese për referendum. Nëse brenda kësaj periudhe nuk mblidhet minimumi i kërkuar nënshkrimeve sipas parashikimeve të këtij ligji, atëherë procedura për propozimin e referendumi ndërpritet. Grupi nismëtar ka detyrimit për të konstatuar pamjaftueshmërinë e nënshkrimeve në fund të afatit 3-mujor, fakt i cili i njoftohet me shkrim KQZ-së.
2. Nëse brenda periudhës 3 mujore të përcaktuar, mblidhet të paktën minimumi i nënshkrimeve të domosdoshme, atëherë Grupi Nismëtar i referendumi i dorëzon KQZ-së dokumentacionin me nënshkrimet përkatëse.
3. Në rastin e mosdorëzimit të kërkesës për zhvillimin e referendumi, grupi nismëtar i tij kryen me protokoll, shkatërrimin e fletëve për mbledhjen e nënshkrimeve. Në këtë proces merr pjesë një përfaqësues i KQZ-së. Në rast se firmat janë mbledhur tërësisht apo pjesërisht me anë të nënshkrimit elektronik, në proces merr pjesë edhe një përfaqësues i autoritetit për nënshkrimet elektronike në Republikën e Shqipërisë.
4. Shkatërrimi i fletëve bëhet jo më vonë se 10 ditë nga kalimi i afatit 3-mujor të caktuar me vendim të KQZ.
5. Procesverbali i firmosur nga që vërteton shkatërrimin e fletëve i dërgohet KQZ nga grupi nismëtar i referendumi brenda 24 orëve.

Neni 23

Verifikimi i nënshkrimeve

1. Me paraqitjen e nënshkrimeve dhe dokumentacionit përkatës nga Grupi Nismëtar, KQZ-ja bën numërimin e firmave të mbledhura si dhe verifikimin e vlefshmërisë së nënshkrimeve brenda 10 ditëve nga depozitimi i tyre në KQZ.
2. Në rast se nga verifikimi rezultojnë nënshkrime jo-autentike, atëherë KQZ i identifikon ato dhe i zbret nga numri total i firmave të grumbulluar për aktivizimin e nismës referendare. KQZ ka detyrimit të provojë saktësinë e verifikimeve të ndërmarra prej saj.
3. Nënshkrimet jo-autentike numërohen dhe identifikohen për aq sa janë dhe nuk mund të anulohen autenticitetin dhe vlefshmërinë e firmave të tjera të grumbulluar nga Grupi Nismëtar.
4. Në rast se numri i nënshkrimeve jo-autentike të konsideruara si të pavlefshme nga KQZ është mbi 5% e totalit të kërkuar për të propozimin e Referendumi, KQZ mund të kërkojë rihapjen e procesit të mbledhjes së firmave nga e para për një periudhë 10 ditore. Në këtë rast, KQZ-ja njofton Kuvendin dhe Grupin Nismëtar.
5. Në rast se grupi nismëtar për referendumin ka mbledhur më shumë firma se pragu ligjor i kërkuar në periudhën kohore prej 3 mujsh dhe nëse numri i votave të vlerësuara nga KQZ si

jo-autentike nuk e cënon sasinë/numrin që nevojitet për të kapërcyer pragun ligjor, procesi nuk ka nevojë të ripërsëritet.

6. Në çdo rast, KQZ-ja merr vendime të arsyetuara, të cilat publikohen në faqen e saj zyrtare menjëherë pas miratimit.

Neni 24

Kontrolli nga Gjykata Kushtetuese

1. Gjykata Kushtetuese vendos për kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij. Ajo shqyrton paraprakisht kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruara për referendum, si dhe bën verifikimin e rezultateve përfundimtare të tij, kur ka pretendime për këtë qëllim, sipas nenit 150, paragrafët 1 e 2, nenit 151 paragrafët 2 e 3 edhe sipas nenit 177 paragrafët 4 e 5 të Kushtetutës.
2. Rëndësia e çështjeve të veçanta për t'u votuar me referendum, të parashikuara në nenin 150 paragrafët 1 e 2 të Kushtetutës, nuk është objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese.
3. Gjykata Kushtetuese, në rastin kur vihet në lëvizje për shqyrtimin e një ligji për rishikimin e Kushtetutës, të votuar me referendum, sipas nenit 177 të Kushtetutës, kontrollon vetëm respektimin e procedurës së parashikuar nga Kushtetuta.
4. Afati brenda të cilit Gjykata Kushtetuese duhet të shprehet me vendim të arsyetuar mbi kushtetutshmërinë e nismës referendare është 60 ditë nga paraqitja e kërkesës.
5. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese publikohet në Fletoren Zyrtare brenda 5 ditëve nga marrja e tij dhe i njoftohet Presidentit të Republikës, Kuvendit të Shqipërisë dhe KQZ-së
6. Kur Gjykata Kushtetuese nuk arrin të marrë vendim brenda 60-ditëve, atëherë Kryetari i Gjykatës apo Sekretari i Përgjithshëm, brenda 10-ditëve të skadimit të afatit 60-ditor njofton autoritetet e mësipërme mbi arsyet e mosmarrjes së vendimit dhe procedura referendare vijon sipas këtij ligji.

Neni 25

Data e referendumit

1. Data e referendumit caktohet nga Presidenti i Republikës brenda 45 ditëve pas shpalljes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese për vlefshmërinë e nismës, ose pas njoftimit të kalimit të afatit brenda të cilit Gjykata Kushtetuese duhet të shprehej.
2. Referendumi zhvillohet jo më parë se 45 ditë dhe jo më vonë se 90 ditë nga data e plotësimit të kushteve të përcaktuar në paragrafin 1.
3. Çështjet e shtruara për t'u votuar me referendum të përgjithshëm në një vit, mund të jenë disa, por votimi për to zhvillohet në një ditë të vetme.

KREU IV
ADMINISTRIMI I PROCESIT ZGJEDHOR PËR REFERENDUMET

Neni 26
Roli dhe kompetencat e KQZ-së

1. Procesi zgjedhor për referendumet administrohet nga KQZ-ja, në bashkërendim me Grupin Nismëtar, Autoritetin përgjegjës për nënshkrimin elektronik dhe institucionet e tjera ligjzbatuese të cilat kanë detyrimin me ligj të garantojmë mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në Republikën e Shqipërisë.
2. KQZ-ja ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - a) Garanton dhe mbikqyr ligjshmërinë dhe siguron zbatimin e drejtë dhe tëbarabartë të parashikimeve ligjore për mbajtjen e referendumit;
 - b) drejton punën e komisioneve zgjedhore për referendumet dhe shqyrton vendimet e miratuara nga to;
 - c) trajton ankesat e ardhura në lidhje me procedurën e organizimit dhe zhvillimit të referendumeve;
 - ç) miraton vendime dhe udhëzime për zbatimin e këtij ligji;
 - d) nxjerr vendime dhe akte të tjera për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të detyrueshme për të gjitha komisionet dhe organet e tjera të përfshira në proces;
 - dh) disponon për mjetet financiare të alokuara për mbajtjen e referendumeve, shpërndarjen e tyre dhe mbikqyr mënyrën e përdorimit të tyre për mbajtjen e referendumeve;
 - e) merr masa për sigurimin e materialeve, mjeteve e bazës teknike si dhe mjeteve të komunikimit përkatëse për të garantuar zhvillimin normal të referendumit;
 - ë) përcakton modelin e fletëve të votimit për referendumin si dhe dokumente të tjera të referendumit;
 - f) përcakton formën e vulës që vendoset në fletët e votimit dhe në gjithë dokumentacionin që shoqëron zhvillimin e referendumit,
 - g) siguron publikimin në media të draftit të paraqitur në referendum;
 - gj) akrediton përfaqësuesit e mediave dhe organizatave ndërkombëtare zbatimin që kryejnë misionet vëzhgimi, sipas një procedure të përcaktuar nga vetë ky institucion;
 - h) përcakton procedurën për përmbledhjen dhe finalizimin e rezultateve të referendumit;
 - i) në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë mbledh dhe shpall rezultatet e referendumit, si dhe procedurën e dorëzimit të dokumentacionit të përdorur në referendum;
 - j) organizon trajnime për anëtarët e komisioneve zgjedhore për referendumin.
3. KQZ-ja ushtron edhe detyra dhe kompetencat e tjera të përcaktuara në këtë ligj dhe në Kodin Zgjedhor.

Neni 27

Fushata për referendumin dhe pasqyrimi në media

1. Fushata për referendumin fillon prej ditës së në të cilën është marrë vendim për lejimin e tij nga KQZ dhe mbyllet 24 orë para votimit për referendumin.
2. Vendimi për mbajtjen e referendunit bëhet publik në media dhe KQZ ka detyrimin të hartojë udhëzimet për mbajtjen e fushatës referendare, bazuar në parashikimet e këtij ligji dhe në përcaktimet e Kodit Zgjedhor .
3. KQZ akordon fond të posaçëm për prodhimin dhe transmetimin e mesazheve informuese audio-vizive që qytetarët të informohen në lidhje mënyrën e votimit në referendum. Teksti i propozimit që do të vendoset në referendum shpallet publikisht në media se bashku me opsionet “PO –JO” apo PRO-KUNDER”.
4. Në pasqyrimin e fushatës referendare, Media respekton të gjitha parashikimet ligjore në fuqi
5. Fushata për referendumin dhe pasqyrimi i saj mediatic, si dhe sondazhet e ndryshme që mund të zhvillohen për referendumin, janë objekt monitorimi nga subjektet e interesuara KQZ harton një raport zyrtar mbi fondet e alokuara, kostot e fushatës dhe sasinë e transmetimit në media të fushatës për referendumin.
6. Organizatat jo-qeveritare gjithashtu monitorojnë fushatën për referendumin dhe nëse hartojnë raport për të, e depozitojnë një kopje të tij edhe në KQZ.

Neni 28

Fleta e votimit për referendum

1. Jo më vonë se 10 ditë nga marrja e vendimit, KQZ-ja përgatit edhe formatin e fletës së votimit për referendum.
2. Formatin e fletës së votimit duhet të jetë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie, sipas përcaktimeve të KQZ-së.
3. Nëse kuadri ligjor
4. Formatin e votimit është i njëjtë për të gjithë territorin e vendit.
5. Fleta e votimit duhet të përmbajë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme tekstin e propozuar për referendum, sipas natyrës së referendunit të përcaktuar në këtë ligj, duke u kërkuar votuesve të shprehen për një nga alternativat të dhëna në variantin “Po” ose “Jo”, apo në variantin “Pro” ose “Kundër”.
6. Nëse Kodi Zgjedhor parashikon apo lejon forma të votimit elektronik për zgjedhje, KQZ aplikon standarte të njëjta standarte ligjore edhe për referendumin sa i takon formatin elektronik të fletës votimit.

Neni 29

Votimi

1. Procedurat, dokumentacioni, administrimi i tij si dhe rregullat e votimit, e numërimit të votave, në referendum përcaktohen nga ky Ligj dhe nga Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë.
2. Çdo shtetasi shqiptar me të drejtë vote i garantohet ta shprehë lirisht dhe drejtpërdrejt mendimin e tij për pyetjet e shtruar në referendum. Vota është vetjake, e fshehtë, dhe çdo votë e dhënë ka të njëjtën vlerë.
3. Votuesi zgjedh vetëm një nga alternativat e dhëna në fletët e votimit, sipas mënyrës së votimit që ka përcaktuar KQZ-ja për këtë qëllim.
4. Procesi i votimit zhvillohet në një ditë të vetme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. KQZ-ja përcakton orën e hapjes dhe mbylljes së votimit në të gjithë vendin dhe modalitetet e tjera të votimit.
5. Votuesit shprehen vetëm për një nga alternativat që përmban fleta e votimit, të dhëna në variantin “Po” ose “Jo”, apo në variantin “Pro” ose “Kundër”.
6. Nëse në të njëjtën ditë organizohet më shumë se një referendum, atëherë fletët e votimit për secilin prej tyre duhet të kenë ngjyra të ndryshme.
7. Në votimin për referendumin, përdoret një kuti e veçantë për çdo çështje që është shtruar për votim. Kutia duhet të përmbajë shenja të qarta dalluese të nismës për referendum të cilës i përket.
8. KQZ-ja përcakton formën tip të fletës së votimit si dhe shpëndan dhe bën publike modelin se si duhet plotësuar fleta e votimit.
9. Në mbyllje të procesit të votimit, bëhet numërimi i votave, referuar alternativave të paraqitura në fletën e votimit në referendum. Në këtë proces, numërohen të gjitha votat, duke nxjerrë totalin e votave për çdo alternativë të dhënë si dhe votat e pavlefshme.
10. KQZ-ja përcakton mënyrën e numërimit dhe dokumentimit të votave të vlefshme për çdo alternativë si dhe atyre që shpallen të pavlefshme, referuar këtij ligji dhe Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 30

Nxjerrja e rezultatit të referendunit

1. Në përfundim të procesit të votimit, KQZ-ja përpunon dhe bën publike të dhënat e mëposhtme:
 - a) numrin e votuesve të regjistruar në listat e votimit në referendum,
 - b) numrin e votuesve që kanë votuar në qendrat e votimit.
 - c) numrin e votave në total.
 - ç) numrin e fletëve të votimit në total, numrin e fletëve të përdorura dhe atyre të papërdorura,
 - d) numrin e votave të vlefshme në favor të alternativës "Pro", ose “Po”,
 - dh) numrin e votave të vlefshme në favor të alternativës "Kundër", ose “Jo”,

- e) numrin e votave të pavlefshme.
2. KQZ-ja në përfundim të procesit të votimit në referendum, dhe numërimit të votave, merr një nga vendimet e mëposhtme:
- a) miratimi nëpërmjet referendumit i çështjes së shtruar për referendum;
 - b) rrëzimi i çështjes së shtruar për referendum;
 - c) deklarim rezultatin e votimit si të pavlefshëm.
3. Drafti i paraqitur në referendum konsiderohet i miratuar nëse për të kanë votuar më shumë se $\frac{1}{2}$ e votuesve që morën pjesë në referendum, por në cdo rast jo më pak se $\frac{1}{3}$ e zgjedhësve në shkallë vendi.
4. Rezultatet e referendumit mund të kundërshtohen në Gjykatën Kushtetuese në përputhje me legjislacionin përkatës.

KREU V REFERENDUMI VENDOR

Neni 31

Çështjet për të cilat mund të kërkohet referendum vendor

1. Qeverisja në njësitë e qeverisjes vendore ushtrohet edhe përmes referendumeve vendore për vendimarrje brenda juridiksionit lëndor dhe territorial të njësisë dhe vetëm brenda funksioneve të cilat i njihen me ligj.
2. Në referendumin vendor, banorët në juridiksionin e një njësie të vetqeverisjes vendore shprehin me votim në referendum vullnetin e tyre për:
 - a) riorganizimin e ndarjes administrativo-territoriale me ose pa ndryshim kufijsh të njësisë të qeverisjes vendore;
 - b) mënyrën e zgjidhjes së çështjeve të një rëndësie të veçantë që prekin njësitë e vetqeverisjes vendore, të cilat përfshihen brenda kufijve, detyrave dhe kompetencave të organit përfaqësues të kësaj njësie;
 - c) vetëtaksimi i banorëve për qëllime publike, brenda kufijve të detyrave dhe kompetencave të organeve të njësisë të qeverisjes vendore;
 - ç) çështje të tjera thelbësore, që iu referohen lidhjeve me natyrë shoqërore, ekonomike apo kulturore që formojnë në një njësi të qeverisjes vendore.
 - d) shpërndarjen e këshillit bashkiak apo këshillit të qarkut;

Neni 32

Pjesëmarrja në referendumin vendor

1. Në referendumin vendor marrin pjesë zgjedhësit që banojnë në territorin e një njësisë së qeverisjes vendore në të cilën zhvillohet referendumi.
2. KQZ nxjerr udhëzime bazuar në Kodin Zgjedhor dhe në legjislacionin për gjendjes civile për të garantuar të drejtën e votimit të shtetasve në njësinë e qeverisjes vendore ku mbahet referendumi.

3. KQZ disponon me vendim të posaçëm për të përcaktuar kohën në të cilën një banor i regjistruar në njësinë e vetëqeverisjes vendore konsiderohet zgjedhës me të drejtë vote për referendumin vendor.

Neni 33

Referendumi vendor me nismë nga organi përfaqësues (nga lart-poshtë)

1. Referendumi vendor mund të zhvillohet me kërkesën e jo më pak se 1/3 së të gjithë anëtarëve të këshillit bashkiak të njësisë së qeverisjes vendore dhe me miratimin e shumicës së të gjithë anëtarëve të këshillit.
2. Kryetari i Bashkisë ka të drejtë t'i kërkojë Këshillit Bashkiak që një çështje të rëndësishme që ka impakt mbi banorët e njësisë së qeverisjes vendore, ta shtrojë për vendimmartje direkt në popull përmes referendunit vendor. Kërkesa e kryetarit të bashkisë merret në shqyrtim nga Këshilli Bashkiak në mbledhjen më të afërt dhe quhet e miratuar nëse pro saj votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të këshillit.
3. Vendimi miratues i Këshillit Bashkiak/të Qarkut për mbajtjen e referendunit vendor përmban:
 - a) pyetjen ose pyetjet e referendunit, apo variantet që i propozohen banorëve të njësisë vendore, për t'u zgjedhur prej tyre;
 - b) afatin e zhvillimit të referendunit;
 - c) mënyrën e votimit dhe sipas rastit, modelin e fletës së votimit
 - d) kalendarin e veprimeve në lidhje me zhvillimin e referendunit
- dh) Në rastin kur objekti i referendunit është vetëtaksimi i banorëve, vendimi i organi përfaqësues duhet të përfshijë qëllimin dhe destinacionin e taksës si parimet dhe mënyrën e vetëtaksimit.
4. Vendimi i Këshillit Bashkiak/të Qarkut për mbajtjen e referendunit shpallet brenda 10 ditëve nga data e miratimit dhe hynë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Neni 34

Referendumi vendor me nismë nga banorët/organizatat (nga Poshtë-Lart)

1. Nismën e zhvillimit të referendunit me kërkesë të banorëve të njësisë së qeverisjes vendore e kanë:
 - a) të paktën 15 shtetas shqiptar me të drejtë vote (grupi nismëtar), të cilët gëzojnë të drejtën për t'u zgjedhur në organet drejtuese të njësisë së qeverisjes vendore;
 - b) një organizatë e shoqërisë civile që ka personalitet juridik, veprimtaria aktive e të cilës, sipas statutit të saj, është e shtrirë të paktën në territorin e njësisë të dhënë të vetëqeverisjes vendore, përfaqësuesit e të cilës gëzojnë të drejtën për tu zgjedhur në organet drejtuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore.
2. Subjektet zgjedhore apo partitë politike nuk kanë të drejtë të marrin nismë për zhvillimin e referendumeve në njësitë e vetëqeverisjes vendore.
3. Kërkesa e grupit nismëtar për referendumin vendor i dërgohet KQZ dhe i njoftohet njoftohet zyrtarisht këshillit Bashkiak ose Këshillit të Qarkut, sipas rastit.

4. Për të konfirmuar nismën për mbajtjen e një referendumi vendor me kërkesë të banorëve të njësisë së njësisë së qeverisjes vendore nevojiten firmat e jo më pak se:

- a) 5 % të banorëve me të drejtë vote në nivel bashkie, sipas regjistrimit më të fundit në Rregjistrin e Gjendjes Civile që administrohet nga organi kompetent;
- b) 5% të banorëve me të drejtë votimi në nivel qarku, sipas regjistrimit më të fundit në Rregjistrin e Gjendjes Civile që administrohet nga organi kompetent.

Neni 35

Seancat e këshillimeve për referendumin vendor

1. Këshilli Bashkiak ose Këshilli i Qarkut, përpara marrjes së nismës për referendum vendor, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë.
2. Këshillimi me publikun, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e
3. këshillit, ose duke përdorur takimet e hapura me banorët e grupet e interesit, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata jofitimprurëse.
4. Kur nisma për referendum vendor merret nga banorët e njësisë së vetëqeverisjes vendore, grupi nismëtar ka të drejtë të paraqisë nismën dhe të shpjegojë qëllimet e saj para këshillit bashkiak apo këshillit të qarkut sipas rastit.
5. Organi për përfaqësues ka detyrimin të dëgjojë në seancë të rregullt të mbledhjes më të parë të këshillit bashkiak grupin nismëtar të referendunit vendor. Organi përfaqësues në nivel vendor mund të vendosë që të thërrasë mbledhje jashtë rradhë për këtë qëllim.
6. Në seancat e këshillimit për referendumin vendor diskutohen edhe çështje që lidhen me kostot e fushatës referendare, kalendarin e takimeve dhe me financimin e fushatës informuese. Këshilli mund të bashkë-financojë mbajtjen e referendunit vendor përmes fondeve të buxhetit të njësisë së qeverisjes vendore ku është thirrur referendumi.

Neni 36

Njoftimi vendimarrjes së këshillit të njësisë vendore

1. Vendimi i organit vendimarrës në nivel vendor lidhur me zhvillimin e referendunit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre.
2. Një kopje e vendimit për mbajtjen e referendunit i dërgohet KQZ, pas konfirmimit nga Prefekti, shoqëruar me kërkesën për të administruar procesin zgjedhor referendar në njësinë e vetëqeverisjes vendore.
3. Kalendarin e veprimeve në lidhje me zhvillimin e referendunit vendor njoftohet zyrtarisht përmes medias vendore ose kombëtare.
4. Udhëzuesi praktik për mbajtjen e referendunit hartohet nga KQZ dhe i bëhet i njohur publikut në një format që përcakton KQZ. Organi vendimarrës i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku zhvillohet referendumi ka të drejtë të hartojë një strategji komunikimi për të bërë të njohura efektivisht për votuesit e NJQV ku thirret/mbahet referendumi rregullat e përcaktuara nga KQZ.

Neni 37

Kërkesat e grupit nismëtar ndaj KQZ

1. Grupi nismëtar për zhvillimin e referendumit vendor i drejtohet me kërkesë me shkrim KQZ-së me synimin e zhvillimit të referendumit.
2. Kërkesa përmban:
 - a) nëse grupi nismëtar është një grup qytetarësh emrat, mbiemrat, adresat e vendbanimit si dhe numrat e kartave të identitetit të anëtarëve të grupit;
 - b) nëse grupi nismëtar është një organizatë e shoqërisë civile, njoftimi përmban emërtimin e Nismëtarit, adresën e selisë si dhe emrin, mbiemrin, adresën e vendbanimit si dhe numrin kartës të identitetit të personit që është përfaqësuesi i saj, ndërsa njoftimit i bashkëlidhet një kopje e vendimit të regjistrimit të organizatës. Përfaqësuesi mund të jetë vetëm personi, të cilit i takon e drejta e zgjedhjes në organet drejtues të njësisë së caktuar të qeverisjes vendore.
 - c) përcaktimi i çështjes e cila do të shtrohet në referendum dhe një relacionin shpjegues me arsyetimin që motivon marrjen e nismës referendare.
 - d) kur kërkesa lidhet me referendumin për çështjen e vetëtaksimit, ajo duhet të arsyetojë qëllimin e vetëtaksimit dhe destinacionin e taksës.
 - e) Kur kërkesa lidhet me shkarkimin e organit përfaqësues ajo duhet të përmbajë motivimin e nismës dhe paraqitjen e shkaqeve që legjitimojnë referendumin për këtë qëllim.
3. KQZ-ja merr në shqyrtim kërkesën dhe vendos për të me vendim të arsyetuar brenda 10 ditësh nga paraqitja e saj.
4. Grupi nismëtar ka të drejtë t'i kërkojë KQZ numrin zyrtar të banorëve me të drejtë votimi, të përfshirë në regjistrin e zgjedhësve të njësisë përkatëse në momentin e thirrjes së referendumit. KQZ brenda 10 ditësh nga marrja e kërkesës njofton me shkrim grupin nismëtar të referendumit, apo përfaqësuesin e tij.
5. Grupi nismëtar vë në dispozicion të Këshillit Bashkiak / Këshillit të Qarkut një kopje të Kërkesës dërguar KQZ. Kërkesa hartohet me shkrim, depozitohet në rrugë zyrtare pranë njësisë së qeverisjes vendore dhe protokollohet prej saj.

Neni 38

Motivimi dhe legjitimiteti i nismës për referendum vendor

1. Referendumi vendor me nismën e organit përfaqësues, apo i propozuar nga kryerari i Bashkisë mund të shtrohet vetëm brenda së fushës së funksioneve që i NJQV ligji 139/2015 “Për Vetë Qeverisjen Vendore” dhe brenda kompetencës tokësore dhe juridiksionale që cakton pwr to ligji “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.
2. Çështjet që lidhen me tërësinë territoriale të Republikës së Shqipërisë, me kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, me buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit, me vendosjen dhe heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme, me deklarimin e luftës dhe të paqes dhe me amnistinë nuk mund të shtrohen në asnjë referendum vendor.

3. Referendumi me nismën e 5% të banorëve me të drejtë vote në njësinë e qeverisjes vendore ku thirret referendumi, mund të shtrohet vetëm për çështje që janë brenda fushës së funksioneve që i njihen me ligj organit të qeverisjes vendore.
4. Çështet mjedisore legjitimohen të shtrohen për referendum edhe nëse organi përfaqësues ka marrë vendim për to. Rezultati i referendumit shfuqizon rezultatin e vendimarrjes së organit vendimarrës.
5. Nisma referendare për vetëtaksim të banorëve për qëllime të investimeve publike, brenda juridiksionit të organeve të njësisë të qeverisjes vendore legjitimohet vetëm si e drejtë pozitive për të mbledhur më shumë të ardhura në buxhetin e bashkisë për një qëllim specifik të identifikuar, i cili i shërben mirëqënies së banorëve dhe zhvillimit social ekonomik të NJQV. Referendumi për vetë-taksim nuk i mbivendoset në asnjë rast të drejtës së organit përfaqësues në nivel vendor për të miratuar buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore dhe nuk prek sistemin e taksave dhe tarifave të miratuara nga Këshilli Bashkiak. Ky i fundit nxjerr vendim të posaçëm për mbledhur dhe shtuar në buxhetin e Bashkisë të ardhurat shtesë që gjenerohen nga vetëtaksioni, nëse rezultati i referendumit është “PRO”.
6. Nisma për shkarkimin me referendum të organit përfaqësues vendor mund të legjitimohet nëse ai shkel haptazi përmes vendimeve që merr Kushtetutën, Ligjin “Për Vetëqeverisjen Vendore”, 1/3 e premtimeve të bëra publike në fushatën zgjedhore. Nisma për shkarkimin me referendum të organit përfaqësues mund të merret edhe në rastet kur vendimarrja me impakt mbi shëndetin e banorëve të asaj NJQV apo mbi mjedisin, refuzohet të konsultohen, apo kur rezultati i konsultimeve nuk merret në konsideratë në vendimarrjen përfundimtare të organit përfaqësues.
7. Shkak për nisjen e një referendumi për shkarkimin e organit përfaqësues vendor është edhe refuzimi për të marrë parasysh 2 peticione rradhazi për një çështje të caktuar, për të cilat kanë nëshkruar jo më pak se 5% e shtetasve me të drejtë votë në atë NJQV.

Neni 39

Njoftimi publik i nismës për referendum vendor

1. Grupi nismëtar i referendumit vë në dijeni publikisht përmes medias dhe mjeteve të tjera të informimit publik banorët e njësisë së qeverisjes vendore, për objektin e referendumit.
2. Informacioni për referendumin duhet të përmbajë pyetjen, ose pyetjet e referendumit, apo variantet e propozuara për t’u përzgjedhur, ndërsa, kur kërkesa ka lidhje me referendumin e vetëtaksimit, edhe qëllimin dhe parimet e vetëtaksimit.
3. Informacioni për referendumin e synuar në lidhje me shkrirjen e parakohshme të organit përfaqësues para mbarimit të mandatit të vetqeverisjes vendore përmban dhe arsytimin e shkrirjes së parakohshme.
4. Grupi nismëtar mund të kërkojë nga organi përfaqësues i njësisë së qeverisjes vendore ku propozohet të mbahet referendumi që të shprehet me vendim për të alokuar burime financiare për njoftimin nismës referendare. Këshilli bashkiak/qarkut vendos kërkesën e grupit nismëtar në axhendën e mbledhjes më të afërt, e cila zhvillohet jo më vonë se 10 ditë nga data e depozitimit të kërkesës.
5. Grupi nismëtar mund të zgjedhë të përballojë vetë shpenzimet për njoftimin e nismës referendare.

Neni 40

Mbledhja e nënshkrimeve dhe formati i nevojshëm

1. Pas shqyrtimit dhe miratimit të kërkesës nga KQZ-ja periudha për mbledhjen e nënshkrimeve është 3 muaj nga nga dita e njoftimit. Grupi nismëtar mbledh nënshkrimet e banorëve që kanë të drejtën e zgjedhjes për organet e njësisë së vetqeverisjes vendore, të cilët dëshirojnë të mbështesin nismën për këtë çështje.
2. Formatimi për mbledhjen e nënshkrimeve përcaktohet me vendim të KQZ-së dhe duhet të përmbajë:
 - a) çështjen që shtrohet për referendum;
 - b) numrin rendor;
 - c) emrin dhe mbiemrin e votuesit,
 - ç) numrin e kartës së identitetit apo pasaportës,
 - d) datëlindjen,
 - dh) vendlindjen dhe vendbanimin,
 - e) nënshkrimin dhe datën.
3. Grupi nismëtar i referendumit vendor, ose përfaqësuesi i tij, në rast nevojë, edhe me nismën e vet, mund t'i japë KQZ shpjegime shtesë dhe t'i paraqesë prova. KQZ mund të kërkojë nga grupi nismëtar i referendumit ose nga përfaqësuesi i tij dhënien e shpjegimeve të tilla, ose paraqitjen e provave.
4. Nënshkrimet për nismën referendare vendore mund të mblidhen tërësisht ose pjesërisht edhe në rrugë elektronike, online përmes portalit që mundëson këtë shërbim, në përputhje me standartin ligjor për nënshkrimin elektronik në Republikën e Shqipërisë.
5. KQZ integron sistemin online të mbledhjes së nënshkrimeve elektronike në faqen e vet zyrtare dhe orienton me udhëzime të kuptueshme që bëhen publike në media audio-vizive si dhe në rrjetet sociale për mënyrën e nënshkrimit elektronik në procesin e mbledhjes së firmave për nisjen e një referendumi.
6. Ofruesit e shërbimit të certifikimit për mbledhjen e nënshkrimeve elektronike online duhet të garantojnë identifikimin e nënshkrimeve dhe printimin e një çertifikate që provon nënshkrimin nga zgjedhësit që janë të regjistruar si banorë të njësisë së vetqeverisjes në të cilën do të zhvillohet referendumi.
7. Të dyja llojet e nënshkrimeve, si ai elektronik ashtu dhe ai në letër kanë vlerë të njëjtë në procesin e numërimit nga KQZ.

Neni 41

Shkatërrimi i fletëve për mbledhjen e nënshkrimeve

1. Në rastin e mosdorëzimit të kërkesës për zhvillimin e referendumit vendor, grupi nismëtar i tij kryen me protokoll, shkatërrimin e fletëve të administruara për mbledhjen e nënshkrimeve.
2. Shkatërrimi i fletëve bëhet jo më vonë se pas 3 ditësh nga kalimi i afatit të shqyrtimit të ankimit sipas parashikimit të nenit 43, pika 1, të këtij ligji. Në këtë proces merr pjesë në cilësinë e vëzhguesit dhe një përfaqësues i KQZ-së.
3. Procesverbalin që vërteton shkatërrimin e fletëve, grupi nismëtar i referendumit ia përcjell KQZ-së dhe këshillit bashkiak/këshillit të qarkut.

4. Në rast se për grupi nismëtar ka përdorur alternativën për mbledhjen elektronike të nënshkrimeve për referendumin vendor, atëherë ai i drejtohet më një kërkesë zyrtare autoritetet përgjegjës që administrojnë sistemin online për aktivizimin e protokollit të fshirjes së nënshkrimeve elektronike.

Neni 42

Përmbajtja e vendimit të KQZ për zhvillimin e referendumin vendor

1. Vendimi i KQZ për zhvillimin e referendumin përmban:
 - a) afatin e zhvillimit të referendumin;
 - b) modelin dhe përmbajtjen e fletës së votimit;
 - c) kalendarin e veprimeve që lidhen me zhvillimin e referendumin.
2. Vendimi i KQZ-së bëhet kurdoherë publik përmes faqes së saj zyrtare në internet ose medias audiovizive kombëtare dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 43

Ankimi ndaj vendimit të KQZ

1. Ndaj vendimit të KQZ, që rrezon kërkesën për zhvillimin e një referendumi vendor si dhe në rastin e mosrespektimit nga ana e KQZ të afatit ligjor të përcaktuar për administrimin e kërkesës, nismëtarit të referendumin i lind e drejta të bëjë ankesë në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditësh nga data e dorëzimit të vendimit.
2. Kolegji Zgjedhor e shqyrton ankesën brenda 10 ditëve nga dita e paraqitjes së ankesës.

Neni 44

Data e mbajtjes së referendumin vendor

1. Referendumi zhvillohet në një ditë pushimi zyrtar dhe afati i fundit i zhvillimit të tij është 60 ditë nga hyrja në fuqi e vendimit që lejon mbajtjen e tij.
2. Nëse çështja ankimohet përpara një gjykate kompetente, referendumi vendor zhvillohet në një ditë pushimi zyrtar, jo më vonë se 60 ditë nga dita, kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë.
3. Në rastin e parashikuar në paragrafin 2, organi përfaqësues i njësisë së veqeverisjes vendore, merr vendimin në lidhje me përditësimin e kalendarit të veprimeve.
4. Kërkesa e qytetarëve, për organizimin e referendumin lidhur me shpërndarjen e parakohshme të organit përfaqësues dhe/ose me shkarkimin e organit ekzekutiv mund të depozitohet vetëm pasi të kenë kaluar 10 muaj nga fillimi i mandatit të organit të qeverisjes vendore, apo 10 muaj pas datës së referendumin të fundit të zhvilluar për të njëjtën çështje, por jo më vonë se 10 muaj përpara përfundimit të mandatit.

Neni 45

Përmbajtja e fletës së votimit

1. Fleta e votimit për referendumin vendor përmban:
 - a) emërtimin e referendumin,

- b) emërtimin e organit apo të grupit nismëtar, i cili ka vendosur zhvillimin e referendumit,
- c) datën e referendumit;
- b) pyetjen ose pyetjet apo variante të propozuara për çështjen që është objekt i referendumit; nëse referendumi konsiston në përgjigjen ndaj pyetjeve të shtruara, në fletën e votimit vendosen gjithashtu edhe shprehjet "po" dhe "jo" ndërsa, kur referendumi konsiston në përzgjedhjen nga votuesi të njërit prej varianteve të propozuara, në krah të majtë të çdonjërit prej varianteve vendoset numri i variantit dhe kuadrati për vendosjen e shenjës, nëse votuesi është pro atij varianti.
- c) udhëzimin lidhur me mënyrën e votimit, përfshirë edhe votimn elektronik nëse është i lejuar të përdoret nga Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë

Neni 46

Vlefshmëria e referendumeve vendore

1. Referendumi është i vlefshëm, nëse në të ka marrë pjesë të paktën 30% e personave me të drejtë vote.
2. Referendumi për shkrimin e parakohshme të këshillit bashkiak apo këshillit të qarkut përpara mbarimit të mandatit, është i vlefshëm nëse në të marrin pjesë jo më pak se 50% e numrit të përgjithëm të listës së zgjedhësve në atë njësi të vetqverisjes vendore dhe në favor kanë votuar 2/3 e numrit të pjesëmarrësve.
3. Rezultati i referendumit është pozitiv, kur në favor të njëres prej alternativave të propozuara për çështjen e parashtruar në referendum, është dhënë më shumë se gjysma e votave të vlefshme.
4. Rezultati i referendumit në rang bashkie për vetëtaksimin e banorëve për qëllime publike është pozitiv, nëse në favor të vetëtaksimit janë dhënë më shumë se 50% e votave të vlefshme.

KREU VI

ORGANET PËRGJEGJËSE, FINANCIMI DHE ANKIMI

Neni 47

Organet përgjegjëse

1. Organi kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.
2. Organet qendrore kushtetuese, njësitë të vetëqeverisjes vendore dhe grupet nismëtare mbartin të drejta dhe detyrime lidhur me thirrjen dhe zhvillimin e referendumit sipas përcaktimeve që parashikohen në Kushtetutë, këtë ligj si dhe në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë sa i përket procesit zgjedhor.
3. Organet përgjegjëse bashkëpunojnë edhe me institucione të tjera publike të cilat janë të parashikuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë për garantimin e mbarëvajtjes së procesit zgjedhor.
4. Media, Organizata të shoqërisë civile dhe partitë politike ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me procesin referendar konform ligjeve në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e tyre.

Neni 48

Detyrat dhe përgjegjësitë e KQZ-së

1. KQZ-ja ka rol aktiv në përgatitjen e referendumit, në njoftimin efikas të procedurës së votimit, informimin e publikut për çështjet e shtruara për referendum, zhvillimin e procesit të votimit, numërimin, administrimin dhe shpalljen e rezultatit të referendumit.
2. Në lidhje me referendumet, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - a) mbikqyr ligjshmërinë dhe siguron zbatimin e barabartë të këtij ligji dhe të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë gjatë përgatitjes dhe zhvillimit të referendumit;
 - b) menaxhon procesin zgjedhor për referendumin nga momenti i miratimit të nismës, ditën e votimit, procesin e numërimit të votave dhe deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar.
 - c) trajton ankesat e ardhura në lidhje me procedurën e përgatitjes dhe zhvillimit të referendumeve;
 - ç) jep sqarime dhe udhëzime për zbatimin e këtij ligji;
 - d) nxjerr në bazë dhe për zbatim të këtij ligji dhe brenda sferës së juridiksionit të saj, vendime dhe udhëzime me fuqi juridike të përgjithshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë
 - dh) disponon dhe alokon mjetet financiare për mbajtje të referendumeve, realizon shpërndarjen e tyre dhe mbikqyr mënyrën e përdorimit të tyre për mbajtjen e referendumeve;
 - e) merr masa për sigurimin e materialeve, mjeteve e bazës teknike si dhe mjeteve të komunikimit përkatëse për të garantuar zhvillimin normal të referendumit;
 - ë) përcakton modelin e fletëve të votimit për referendumin si dhe dokumente të tjera të referendumit;
 - f) përcakton formën e vulës që vendoset në fletët e votimit dhe në gjithë dokumentacionin që shoqëron zhvillimin e referendumit, si dhe përcakton procedurën për kthimin e vulave pas referendumit;
 - g) siguron publikimin në media të draftit të paraqitur në referendum;
 - gj) akrediton përfaqësuesit e mediave dhe organizatave ndërkombëtare që kryejnë misionet vëzhgimi, sipas një procedure të përcaktuar nga vetë ky institucion;
 - h) përcakton një procedurë të vetme për përmbledhjen dhe finalizimin e rezultateve të referendumit;
 - i) në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë përmbledh dhe shpall rezultatet e referendumit, si dhe procedurën e dorëzimit të dokumentacionit të përdorur në referendum;
 - j) organizon trajnime për anëtarët e komisioneve të referendumit;
 - k) në rast të shkeljes së kërkesave të këtij ligji, për çështje të organizimit të referendumit, mund t'i drejtohet organeve kompetente përkatëse;
3. Kryen detyra të tjera të përcaktuara në këtë ligj dhe në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 49
Financimi i referendumeve të përgjithshme

1. Në referendumin e përgjithshëm, të gjitha kostot dhe shpenzimet mbulohen nga buxheti i shtetit.
2. Kuvendi vë në dispozicion të KQZ-së dhe të institucioneve të tjera përkatëse fondet për përgatitjen, zhvillimin, mbikëqyrjen, si dhe çdo aspekt tjetër të procesit.
3. Shpërndarja dhe përdorimi i mjeteve financiare nga KQZ-ja për mbajtjen e referendumeve, bëhet në përputhje me këtë ligj dhe Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 50
Financimi i referendumeve vendore

1. Shpenzimet e referendunit vendor mbulohen nga buxheti i njësisë së vetqeverisjes vendore, në të cilën mbahet referendumi. Në rastin e referendunit në rang qarku, shpenzimet referendunit përballohen nga kontributet e përbashkëta të bashkive që janë pjesë e atij qarku. Fondet e alokuara transferohen nga buxheti i shtetit, jo më vonë se 30 ditë përpara ditës së referendunit.
2. KQZ mbulon me mjetet e veta financiare shpenzimet për mbajtje të referendumeve vendore që lidhen me administratën zgjedhore, burimet njëzëre që angazhohen në procesin e administrimit dhe numërimit të votave, bazës logjistike, kostove të informimit publik lidhur me modalitetet e votimit për referendumin. KQZ mbikëqyr mënyrën e përdorimit të fondeve të alokuara prej saj për mbajtjen e referendumeve;
3. Shpenzimet e KQZ që lidhen me organizimin dhe mbajtjen e referendunit për shpërndarjen e parakohshme të këshillit bashkiak ose këshillit të qarkut mbulohen nga buxheti i shtetit, në pjesën që i takon KQZ.
4. Grupit nismëtar që autorizohet për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën referendare mund të zgjedhë të mbulojë shpenzimet me/nga burimet e veta. Ky vendim i komunikohet me shkrim në çdo rast organit përfaqësues në nivel vendor. Në një rast të tillë, grupit nismëtar të referendunit vendor nuk mund t'iu transferohen mjete financiare që burojnë nga buxheti i institucionit publik.
5. Financimi i referendumeve vendore mund të bëhet përmes kontributit financiar të personave fizik me kombësi shqiptare dhe personave juridik me ortakë ose aksionerë me kombësi shqiptare, veprimtaria aktive e të cilës, sipas statutit të saj, është e shtrirë të paktën në territorin e njësisë së qeverisjes vendore ku do mbahet referendumi.
6. Në rastin e aplikimit të nënshkrimit elektronik për firmat që nevojiten për të aktivizuar nismën referendare, shpenzimet përballohen nga Autoriteti përgjegjës i parashikuar në ligj për këtë qëllim.

Neni 51
Ankimi

1. Të drejtën e ankimit, kundër vendimeve të KQZ-së kur ato çenojnë interesat e tyre të ligjshëm për referendum brenda afateve të vendosura me këtë ligj, e kanë individët apo subjektet e legjitimuara të cilëve u është refuzuar kërkesa sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Ankimi paraqitet në KQZ ose në Kolegjin Zgjedhor, sipas procedurave që parashikohen në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.
3. Të drejtën e ankimit, kundër vendimeve të administratës zgjedhore që vijnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji e kanë nismëtarët e referendumit në nivel qendror ose vendor, organizatat e shoqërisë civile dhe individët.
4. Kundër veprimit ose mosveprimit të organeve të tjera shtetërore, ankimi bëhet sipas procedurave përkatëse ligjore në fuqi.

Neni 52

Sanksionet

1. Mbarëvajtja e referendumit garantohet me ligj në Republikën e Shqipërisë. Cënimi i procesit referendar konsiderohet veprë penale dhe ndëshkohet sipas parashikimeve që përmban Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
2. Parashikimet që përmban Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë mbi veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve aplikohen njësoj në rastin e procesit zgjedhor për referendimet.
3. Shkelja e dispozitave të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur përbën veprë penale, cilësohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 100 000 mijë deri në 500 000 mijë lekë.
4. Shkelja e dispozitave të këtij ligji, që kanë për qëllim pengimin e procesit referendar apo shtyrjen e tij drejt dështimit, me përjashtim të rasteve kur përbën veprë penale, cilësohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 2-5 milion lekë. Çdo pretendim në lidhje me këtë çështje shqytohet në KQZ dhe vendimi i këtij organi ankimohet në Kolegjin Zgjedhor. Kur shkelësi i pretenduar është vet KQZ ankimi paraqitet në Kolegjin Zgjedhor, i cili në vendimin e tij duhet të shprehet edhe për anëtarin apo funksionarin e KQZ që ka kryer shkeljen. Në këtë rast, gjoba paguhet individualisht nga personi funksionar që ka konsumuar kundravajtjen. Vendimi i Kolegjit Zgjedhor në këtë rast përbën titull ekzekutiv të detyrueshëm për zbatim nga Shërbimi Përmbarimor Privat/Publik.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 53

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji dispozitat për Referendimet në Kodin Zgjedhor si dhe çdo akt tjetër ligjor ose nënligjor që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 54

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.